



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:024203

Datë: 28.06.2019

Numri i dokumentit: 00382458

PKR. nr. 75/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE - Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, me Gjyqtari Gëzim Pozhegu Kryetari i trupit gjykues, anëtarët e trupit gjykues Shaqir Zika dhe Manduhije Sylja dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.T.I. nga Gjakova, për shkak të veprës penale:blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 parg. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të rënda, PP/I.nr.30/18 të dt. 31.12.2018, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, Ramiz Buzhala, të akuzuarit si dhe mbrojtësit të të akuzuarit avokat A.R., me datë 20.06.2019, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 28.06.2019, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B.I.**, i biri i T. dhe i M. e gjinisë Sh., data e lindjes..., në Gjakovë, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i divorcuar, i gjendjes së dobët ekonomike, numër personal ..., ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se:

Pa autorizim ka poseduar me qëllim shitje substancë narkotike e cila me ligje është shpallur si narkotikë, në atë mënyrë që ditën kritike me dt.05.04.2018, në orën 19:20 min, hetuesi i Njësitit për Hetimin e Trafikimit me narkotik - DHTN në Gjakovë gjatë zbatimit të hetimit me masë të fshehtë me emrin "S.", në bazë të urdhëresës të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë nën Ppr.KR.nr.19/18, të datës 28.03.2018, në rrugën "Gj. S." – Lagja D. në afërsi të lokalit të lojërave të fatit "K." KA NDALUAR TË PANDEHURIN B.I. i cili është takuar me A.M. nga i cili ka blerë substancat narkotike dhe atë të llojit Marihuana ashtu që gjatë kontrollit fizik të bërë ndaj të njëjtit, në trupin e tij është gjetur një (1) folje alumini me mbishkrimin "Bonita" e mbushur me substancë narkotike të llojit heroin me peshë 0.53 gram dhe një (1) qese najloni të tejdukshme e mbushur me substancë narkotike të llojit Marihuanë në peshë prej 2.37 gram .

- me çka ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve , substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 6, 17, 41, 43, 46 51, par.1 dhe 2, 73, 75, e 76, 83 nenit 273 par.1 dhe par.5 të KPK-së si dhe neneve 359 par.2, 365, 450, të KPPK-së, të akuzuarin e

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 300,00 EURO DHE DËNIM ME BURG NE KOHËZGJATJE PREJ DY (2) viteve.

Në të cilin dënim në bazë të nenit 83 llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 17.03.2019. e deri më 20.06.2019.

kështu që në bazë të nenit 51 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, i shqiptohet

DËNIM ME KUSHT

Dënimi me gjobë në shumë prej 300,00 euro dhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, që i është shqiptuar të pandehurit B.I., nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari B.I. në afat prej tre (3) viteve nuk kryejnë vepër të re penale.

Në kuptim të nenit 450 par.4 të KPPK-së, i akuzuari obligohet që të paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej njëzetepesë (25) €, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzetepesë (25) € si dhe shumë prej pesëdhjetë (50) € në emër të kompensimit të viktimave të krimit, konform neni 39 par.3, nënpar.3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e cila shumë duhet paguar në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Në kuptim të nenit 62, të par.1 dhe 2, nënpar.2.7, lidhur me nenin 273 par.5 të KPRK-së konfiskohet substancë narkotike të llojit heroin me peshë 0.53 gram dhe një (1) qese najloni të tejdukshme e mbushur me substancë narkotike të llojit Marihuanë në peshë prej 2.37 gram, e cila pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit do të shkatërrohet.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të rënda në Gjakovë ka ngritur aktakuzën PP./I.nr.30/18 të datës 31.12.2018, kundër të akuzuarit B.I. nga Gjakovë, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve , substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së

I akuzuari B.I. në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë 21.03.2019, pas leximit të aktakuzës, i akuzuari është deklaruar i pafajshëm.

Seanca e shqyrtimit të dytë, është mbajtur me datë 23.04.2019, ku Gjykata me aktvendimin PKR.nr.75/18 të dt. 24.04.2019, ka Refuzuar kërkesën e mbrojtësit të akuzuarit për hüdhen e aktakuzës së Prokurorisë Themelore - Departamenti Krimeve të Rënda në Gjakovë, si të pa bazuar.

Në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datën 20.06.2019, pasi që nga Gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 326 të KPPK, kështu që pas konsultimeve të bëra të akuzuarit B.I., ka deklaruar se është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe shtonë së këto deklarime paraqiten si shprehje të vullnetit të lirë pas konsultimeve me mbrojtësin e tij av. A.R. nga Gjakova, pasi ai është kryes i kësaj vepre penale, prandaj e pranoi në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar sipas aktakuzës.

Dhe se pranimi i të akuzuarit është mbështetur edhe në raportit të oficerit policor L.B. me nr..., i dt. 25.03.2018, dëftesës së konfiskimit të pronës me numër të njëjtë të datës 05.04.2018, transkriptit që ka të bëjë me masën e fshehtë të përgjimit lidhur me komunikimin në mes të pandehurit B.I. dhe dëshmitarit A.M. me nofken "S." i përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e policisë me dt. 05.04.2018, fotove të substancës narkotike si dhe provave tjera materiale të bashkangjitura Kallëzimit penal të policisë.

Pas deklarimit të pandehurit B.I. për pranimin e fajësisë, kryetari i trupit gjykues kërkon që mendimin e vet për këtë ta jap Prokurori i shtetit.

Prokurori i shtetit thotë se pajtohet me deklarimin e të akuzuarit B.I. mbi pranimin e fajësisë dhe konsideron se deklarimet e tilla janë plotësisht të vullnetshme nga ana e të akuzuarit dhe njëherit janë të mbështetura edhe në provat tjera të paraqitura në aktakuzë.

Në vijim, gjykata duke e shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të vullnetit të lirë të akuzuarit, pasi ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pranimi i fajit është bërë pas konsultimeve të nevojshme në mbështetje të fakteve të prezantuara në aktakuzë, konform nenit 246 të KPPK-së.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 248 të KPPK-së si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 246 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, shqyrtimi ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve në kuptim të nenit 352 të KPPK-së.

Prokurori i Shtetit Ramiz Buzhala në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me vet pranimin e fajësisë nga i akuzuari B.I. veprimet faktike të të njëjtit të përshkruara në dispozitiv të aktakuzës, u dëshmuar se janë të bazuara dhe të provuara me ligj, andaj vlerësojmë se në veprimet e të njëjtit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilët ngarkohet me aktakuzë për çka të njëjtin e konsideroj përgjegjës, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.I., av. A.R., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse kemi pranuar fajësinë edhe një herë i propozoj gjykatës që pranimi i fajësisë me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të merren për bazë të gjitha benifitet lidhur me shqiptimin e sanksionit. Njëherit i propozoj gjykatës që ti shqyrtojë të gjitha rrethanat lidhur me të akuzuarin e posaçërisht faktin se i njëjti ka një fëmijë të mitur, është i ndarë nga bashkëshortja, është i obliguar në mbajtje, ruajtje dhe edukim, andaj mbi këtë bazë i propozoj gjykatës si më lartë.

I akuzuari B.I. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se pajtohet me deklaratën e mbrojtësit të tij dhe nuk ka çka të shtoj.

Me faktet e ofruar si dhe pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit pa dyshim rrjedh se në veprimet e të akuzuarit B.I. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.1 dhe nenit 74 par. 3 të KPRK-së.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin B.I., Gjukata ka vlerësuar se i njëjti është mbajtës i vetëm i familjes, se i njëjti është penduar për veprimet e kryera dhe duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërit vepra të tilla si dhe nuk do bie ndesh me ligjin, sjelljen korrekte të pandehurit pas kryerjes së veprës penale si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor. Si rrethanë tjetër e posaçërisht lehtësuese gjykata e merr faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale, e duke i vlerësuar këto rrethana si posaçërisht lehtësuese konform nenit 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-së të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit me të cilën do të arrihet edhe qëllimi i dënimit. Gjukata për të pandehurit nuk ka gjet asnjë nga rrethanat rënduese.

Duke i vlerësuar kështu të gjitha rrethanat e parashikuar me nenin 73 par.1 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjukata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë gjenerale për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 par 1 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas shpalljes së këtij aktgjykimi gjyqtari i udhëzoi palët me të drejtë ankese, se mund ta parashtrajnë në përputhje me nenin 368 par.1 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë,
PKR.nr. 75/18 datë 20.06.2019.**

Zyrtarja ligjore,

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari,

Arbënore Basha

Gëzim Pozhegu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.